REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 872-879/20
Datë/Datum. 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.872/20
879/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Rahovica Comerce"shpk – Ferizaj, si dhe OE "HAXHA KOM"shpk – Skenderaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "Kosova Asfalt"shpk & "Alfa.I"shpk-Ferizaj (LOT 1), si dhe OE "Bujar Shabani B.I" & "Agim Morina B.I"-Ferizaj (LOT 2), lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra sipas LOT 1 dhe LOT 2", me nr. të prokurimit: VU644-20-4423-5-1-1, & Vu644-20-050-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): "Komuna Vushtrri", më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHEN</u>, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatorëve ekonomik "Rahovica Comerce"shpk – Ferizaj, si dhe OE "HAXHA KOM" shpk – Skenderaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra sipas LOT 1 dhe LOT 2", me nr. të prokurimit: VU644-20-4423-5-1-1, & Vu644-20-050-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "Komuna Vushtrri".

II. <u>ANULOHET</u>, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra sipas LOT 1 dhe LOT 2", me nr. të prokurimit: VU644-20-4423-5-1-1, & Vu644-20-050-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK): "Komuna Vushtrri", dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesat e operatorëve ekonomik ankues "Rahovica Comerce"shpk – Ferizaj, si dhe OE "HAXHA KOM"shpk – Skenderaj, aprovohen si pjesërisht të bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Rahovica Comerce" shpk – Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 30.10.2020 me nr. 872/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra sipas LOT 1 dhe LOT 2", me nr. të prokurimit VU644-20-4423-5-1-1, & Vu644-20-050-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "Komuna Vushtrri", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1, 6, 7, 59, 61, 69 dhe 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 39 të RRUOPP.

Operatori ekonomik ankues "HAXHA KOM"shpk – Skenderaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: 02.11.2020 me nr. 879/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra sipas LOT 1 dhe LOT 2", me nr. të prokurimit: VU644-20-4423-5-1-1, & Vu644-20-050-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) "Komuna Vushtrri", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60, 61, 64 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, se dhe Rregullorja per çmime jo-normalisht te ulëta.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.11.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 16.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues nr.872/20 – Rahovica -Ferizaj

Përgjigje në pretendimin e parë ankimor

Eksperti i OSHP-së sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, se AK-Komuna Vushtrri nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore te OE ankues, është shkelje e nenit 108/A te LPP-së.

Pas çdo kërkesë për rishqyrtim AK duhet te pezulloj aktivitetin e prokurimit dhe duhet te kthej përgjigjen brenda afatit kohor.

Paragrafi 2 i nenit 108/A te LPP-se thotë: "Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar"

Pas pezullimit AK duhet te kthej përgjigjen sipas afatit kohor te paraparë me paragrafin 6 te nenit 108A te LPP-se.

Paragrafit 6 te këtij neni qe thotë: "Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë".

Pra, AK nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së për ta shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim, deri ne datën e dorëzimit te ankesës ne OSHP, andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e dytë ankimor

Eksperti i OSHP-së, sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues, sqaron se ne dosjen e OE ankues gjendet një marrëveshje-parakontrate e nënshkruar ne mes te OE. "Rahovica Comerce" dhe z.Gazmend Himaj(menaxher i projektit) inxhinieri i dipl. ndërtimtarisë. Kontrata është e nënshkruar me dt.17.09.2020 deri ne përfundim te projektit "Asfaltimi i rrugëve ne lokale ne fshatra LOT 1 dhe LOT 2" me nr.prok.VU-644-20-4423-5-1-1 .

Sipas dëshmive te bashkangjitura ne dosjen e OE ankues, kriteri i kërkuar ne FDT dhe Njoftim per kontrate plotësohet nga OE. "Rahovica"-Ferizaj.

Kriteri i kërkuar i AK-së te Kërkesa 2 është:

Një (1) inxhinier i dipolumar i Ndërtimtarisë apo master, 3 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Konstruktiv), në detyrë të menaxherit të projektit, i emëruar me vendim përgjegjës i drejtpërdrejt për ekzekutimin e projektit. Të ketë menaxhuar së paku një (1) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

Dëshmia 2. dëshmitë e kërkuara si vijon Për pikat a dhe b Diploma kopje, CV-a kopje e nënshkruar, referenca e lëshuar nga punëdhënësi për projektin e realizuar e nënshkruar dhe e vulosur, Kontrata e punës apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënësi si dhe e vulosut nga Punëdhënësi, të dorëzohet në kopje. Vendimi mbi caktimin e menaxherit projektit dhe udhëheqësit të punishtes të projektit i nënshkruar dhe i vulosur.

Lidhur me inxhinierin ne fjale, ne dosjen e OE ankues gjindet para- kontrata, CV, Diploma, referencat e kryerjes se punimeve, gjë qe nënkuptohet se OE ankues e plotëson kriterin e kërkuar të AK-së si ne FDT dhe Njoftim për Kontrate.

Lidhur me sqarimin e AK-se qe i ka kërkuar Inxhinierit te ndërtimtarisë - Gazmend Himaj, sqarojmë se AK ka qene dashtë ti kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së nga OE ankues (OE. Rahovica), pasi qe inxhinieri ne fjale është punëtor i kompanisë "Rahovica Comerce", pasi qe ofertues është Operatori Ekonomik e jo individi (inxhinieri).

Për të gjitha sqarimet AK është dashur te kërkoj sqarime shtese nga OE, si ne rastin konkret nga OE."Rahovica Comerce", këtë e përcakton edhe paragrafi 1 i Nenit 72 i LPP-së që thotë se:

"Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".

Pra, AK është dashur ta sqaroj sipas nenit 72 te LPP-se, për inxhinierin ne fjale, por ne rastin ne fjale AK i ka kërkuar sqarime direkt inxhinierit, gjë qe AK nuk e ka respektuar si duhet nenin 72 të LPP-së, sepse ofertimi është si kompani e jo si individ.

Pra, gjate fazës se vlerësimit te ofertave AK-Komuna Vushtrri i ka kërkuar sqarime inxhinierit te ndërtimtarisë Gazmend Himaj, ku i njëjti thotë se nuk jam inxhinier i kompanisë dhe se punoj ne një kompani tjetër. Sipas sqarimit qe ka kërkuar AK- Komuna e Vushtrrisë nga inxhinieri i ndërtimtarisë, Gazmend Himaj, thotë (citim): "Une nuk kam nënshkruar asnjë dokument lidhur me projektin ne fjale, si marrëveshje bashkëpunimi apo parakontrate. Ju njoftoj personalisht se përgjegjësitë qe rrjedhin nga ajo parakontrate pasi qe unë personalisht nuk e kam nënshkruar atë kontrate. Ne fund edhe një here deklarohem se diploma, CV janë keqpërdorur pa dijeninë time dhe unë aktualisht jam i punësuar ne kompaninë DT Mining Sh.p.k dhe VB Invest Sh.p.k, dhe aty jam punëtor i rregullte.

Ne dosjen e OE ankues "Rahovica Comerce" gjendet një Vërtetim i diplomës me noter i cili vërtetim është bere nga vet z.Gazmend Himaj. Dokumenti noterial ka këtë numër: LRP, Nr.rendor 15039/2019, e datës 20.12.2019.

Si është e mundur te paguhen kontributet për një person nga OE me te cilin ka para/kontrate pune, e ka CV-ne ne dosje, diplomën e noterizuar nga vet inxhinieri (Himaj), është i deklaruar ne listën e ATK-së per muajin 09/2020 qe i ka paguar kontributet pensionale, kurse i njëjti thotë se nuk jam punëtor i kompanisë dhe nuk kam nënshkruar asnjë dokument.

Po ashtu ne dosjen e OE ankues gjindet një mesazh i cili është i printuar nga OE ankues, ku i njëjti mesazh është dërguar përmes telefonit-viberit nga inxhinieri i ndërtimtarisë z. Gazmend Himaj, ku thotë (citim): Fehmi dhe Endrit ju kërkoj falje për këtë qe ka ndodh nuk ju kam bo unë me beso, dikush ka shpiunu ne firmën time dhe i ka tregu qe i kam letrat te ju. Dhe me beso nuk kam dashtë me ta bë ketë sikurse nuk ta kam ba edhe ne tenderat e tjerë por nuk e kam ba me deshire me beso. Nuk pata qa bojë se nuk munda me humb punën se mu rreziku edhe vendi i punës dhe spata zgjidhje tjetër se edhe unë kam familje. Jam tmerrësisht keq për këtë qe na ndodhi. Ju kërkoj falje shume shume ishalla ma bani hallall.

Mesazhi kthyes i përfaqësuesit të OE ankues "Rahovica Comerce" qe i është drejtuar inxhinierit Himaj është: Pershndetje Gaz, ti ki marrëveshje me mu dhe ke me tregu para Policisë sa pare ke marr sepse kam dëshmi qe rroge ke marr prej kompanisë time, për këto lojna ke gabu ti me gjithë qata qe te kane shti ne ketë loje, se mendoj se ka ligj ne këtë vend.

Pra, përmes mesazhit inxhinieri nuk e mohon se nuk është punëtor i kompanisë!

Po ashtu ne dosjen e OE ankues gjinden edhe disa mesazhe tjera qe është paguar si punëtor i kompanisë, gjinden foto te inxhinierit me përfaqësuesit e kompanisë për nënshkrim te kontratës etj, ashtu siç e pohon OE ankues ne ankesën e tij.

Kurse sa i përket sqarimit te kërkuar nga AK për inxhinierin ne fjale, ne dosjen e ankesës gjinden disa dëshmi se OE ankues e ka te punësuar inxhinierin ne fjalë, ku është i deklaruar ne listën e pagave te periudhës 09/2020 te dorëzuar ne ATK i cili ka page 250.00 €.

Pra, këtë liste te pagave te ATK-së, OE ankues e ka dërguar ne kërkesën për rishqyrtim ne Autoritetin Kontraktues Komuna Vushtrri.

Lidhur me këtë pretendim, pasi qe ne dosjen e tenderit gjinden para kontrata, diploma, CV-ja, mesazhet kërkim falëse te inxhinierit zt.Gazmend HIMAJ, noterizimi i diplomës, dëshmitë e pagesave etj.

Bazuar ne dëshmitë qe gjinden ne dosjen e OE ankues, ne momentin e dorëzimit OE i ka përmbush kriteret e FDT-se, NJK-se, se inxhinieri ne fjale ka para kontratë, ka diplomën e noterizuar, lista e punëtorëve deklaruar ne ATK për muajin 09/2020, ku inxhinieri Gazmend Himaj është edhe si i punësuar dhe mendoje se ky pretendim ankimor i OE ankues ne këtë pike është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e trete ankimor

Eksperti i OSHP-së, sqaron se: Lidhur me arsyetimin e AK-se se ne si OE nuk i kemi referencat për plotësimin e kriterit te kërkuar: Kërkesa 1. Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme (ndërtim, rehabilitim, rikonstruimit të rrugëve) në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, jo më pak se për LOT-1 1,299,064.91€, dhe për LOT-2 1,820,261.43€ Në rast Grupit të Op.Ek. lideri i grupit duhet të ketë kontrata të punës të realizuara gjatë tre viteve të fundit deri më datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë jo më pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë.

OE ankues ne listën e projekteve ka projekte me vlere 3,224,674.00 €, ku nga ato projekte AK duhet te kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së, ku duke u bazuar ne nenin 1 dhe 6 te LPP-se, qëllimi i Ligjit është shfrytëzimi sa me ekonomik i buxhetit dhe AK ti kërkoj sqarime shtese ne fazën e rivlerësimit qe ne rast se arrihet kriteri i kërkuar nga OE ankues AK te shpërblen me kontrate OE ankues, ne rast se nuk arrihet kriteri i kërkuar AK te vazhdoj me OE tjerë. Pra qëllimi i LPP-se konkretisht nenit 59.2, nenit 72 te LPP-së dhe nenit 39.8 te RrUOPP-së është ti kërkohen sqarime shtese.

Pra, AK duke u bazuar ne nenin 1 dhe 6 te LPP-së qe interesi i AK është te kursej buxhetin, AK duhet te ketë parasysh këto gjera dhe ka qene dashtë te kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 te LPP-së, lidhur me listën e projekteve, konkretisht referencat.

Pretendimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e katërt ankimor

Eksperti i OSHP-së sqaron se: Lidhur me pretendimin e OE ankues për çmime jo normalisht te ulëta, sipas pozicioneve te përshkruara si me poshtë:

Ne pozicionin nr.7 Furnizimi dhe punimi i pusetave te reja duke përfshirë furnizimin dhe montimin e gypave te pesetës Ø 1000 se bashku me konus Ø 1000/600 si kapaku prej kompoziti me peshe 40 T.

OE i rekomanduar "Bageri", ka ofertuar me çmim 1.00 €, kurse OE ankues, ka marr oferta nga prodhues ku çmimi është 100.00 €, pasi qe OE ankues, thotë: "ne jemi importues te kapakëve kompozitë, kurse ne kemi ofertuar me çmim 120.00 €". Si është e mundur ne si importues e kemi çmimin 120.00 €, kurse OE i rekomanduar e ka çmimin 1.00 €. Poashtu edhe ne pozicionin nr.9 Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe sekondar ne kat.III-IV te dheut me makine në gjerësi B=60 cm, ku OE i rekomanduar ka çmim 0.10 €, kurse çmimi real për pune te tilla është min.1.00 € (m3

Ne pozicionin nr. 19 Furnizimi dhe betonimi i elementeve konstruktive me beton te armuar C25-30 Mpa, sipas projektit, ku OE i rekomanduar ka çmim 1.00 €, kurse siç pretendon OE ankues, se çmimi i tregut është 40-45 € = 1 m3. Pra, si është e munduar me 1.00 € te vendoset çmimi për 1 m3 beton C25-30 .

Ne pozicionin nr.10 Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave te brinjëzuar PE SN 8 për kolektorët e kanalizimit fekal PESN8 Ø 315 mm, ku OE i rekomanduar ka vendosur çmim 0.20 € për 1 metër gjatësi,

kurse kurse siç pretendon OE ankues, se çmimi i tregut është çmimi nga 6.00 – 6.50 €, ku NE (OE ankues) kemi ofertuar me çmim 7.00 €.

Ne pozicionin nr. 20 Blerja, transporti, prerja dhe vendosja e armaturës ÇBR-400/500 Mpa ne tërësi ne te gjitha pozicionet sipas llogarisë statike, ku OE i rekomanduar ka ofertuar 0.01 €/kg, ku vetëm blerja kushton 1 kg = 0.40 €, siç pretendon OE ankues.

Pra, si është e mundur OE. "Bageri" te oferton me 0.01 €, ku as ne prodhim nuk është me lire se 0.33 €/kg.

Këtu shihet haptas se ka çmime jo-normalisht te ulëta, dhe AK nuk ka vepruar fare sipas nenit 61 te LPP-se për ti vërtetuar këto çmime!

Sqarim:

Te gjitha çmimet qe i ka potencuar OE ankues ne ankesën e tij, shihet se janë çmime te cilat janë te lira dhe obligim dhe përgjegjësi e AK-se është te kërkoj sqarime sipas paragrafit 2 te nenit 61 te LPP-se dhe Neni 4 (procedura e shqyrtimit) i Rregullores për çmime jo-normalisht te ulëta Neni 4 -Procedura e shqyrtimit (inter partes)

Paragrafi 2 i nenit 61 te LPP-së thotë (citim): Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

1.ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

2.çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

3.çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve,

4.ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

5.origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Pretendimi i ankimor i OE ankues ne këtë pike është i bazuar, sepse AK ka qene dasht ti kërkoj sqarime shtese OE ankues për çmime jo normalisht te ulëta.

<u>Përgjigje ne pretendimin e peste</u>

Eksperti i OSHP-se lidhur me pretendimin nr.5 te OE ankues

Po ashtu, lidhur me pretendimin e OE ankues, ku kërkesa e kërkuar nga AK ka qenë në FDT dhe NJK:

Kërkesa 6. Operatori Ekonomik duhet te këtë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr.

Dëshmia 6. Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje për aktivitete te veçanta , valide dhe e vlefshme e lëshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet

ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licenca e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit.

Pra, OE i rekomanduar nuk e ka te noterizuar marrëveshjen për Furnizim me zhavorr ne emër te qiramarrësit dhe qiradhënësit, kurse OE i rekomanduar nuk e plotëson këtë kriter.

Pra, nuk është marrëveshja e noterizuar sipas kërkesës se AK-se, por ka vetëm vërtetim nënshkrimi i dt.11.03.2020, ku thotë se Noteri ne kuptim te nenit 46 vërteton dokumentin kopje nga origjinali, gje qe e vërteton se nuk është marrëveshja e noterizuar për projektin, por është vetëm vërtetim nënshkrimi i kopjes se marrëveshjes, qe mendoj se nuk e përmbush plotësisht kriterin e kërkuar të AK-se i cili është kërkuar ne FDT dhe NJK. Pra, AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se, konkretisht paragrafi 4 i këtij neni qe thotë:

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Pra, ashtu siç pretendon OE ankues, OE i rekomanduar nuk e ka marrëveshjen e noterizuar ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit, pos qe e ka noterizimin e bere nga pronari për LOT 2 – Bujar Shabani.

Pra, duke u bazuar ne kërkesën e AK-së dhe dëshmitë qe OE i rekomanduar i ka futur ne dosje, nuk e plotëson kriterin e kërkuar OE i rekomanduar.

AK duhet te këtë parasysh nenin 7 te LPP-se (mos-diskriminimin) e OE-ve dhe respektimin e kritereve te kërkuara sipas nenit 59 te LPP-se, duke mos anashkaluar nenin 1 të LPP-së, nenin 6, nenin 61 dhe 72 te LPP-së.

Pra, Pretendimi ankimor ne këtë pike mendojmë se është i bazuar.

Pretendimi ankimor i OE ankues HAXHA KOM-Skenderaj nr.879/2

Përgjigje ne pretendimin e parë ankimor

Eksperti i OSHP-se, sqaron se lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues per shkeljen e nenit 61 te LPP-se, AK nuk e ka respektuar nenin 61 te LPP-se ne lidhje me tenderin jo-normalisht te ulet, ku ceket qarte se: Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Pra, AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e lartcekura te nenit 61 te LPP-së pasi qe nuk i ka kërkuar fare sqarime shtesë ne lidhje me çmimin e OE se rekomanduar për kontratë dhe duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit.

Përgjigje ne pretendimin e dytë ankimor

Eksperti i OSHP-së, sqaron se pretendimi i njëjtë është shqyrtuar edhe ne ankesën nr.872/20,

Andaj duke u bazuar ne faktet e lartcekura shihet qarte se OE i rekomanduar për kontrate nuk e plotëson kriterin e kërkuar si ne FDT, sepse marrëveshja nuk është e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit, por marrëveshja është noterizuar nga Bujar Shabani LOT 2, dhe Valdrin Shabani LOT 1, por nuk është e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit, ashtu siç është përcaktuar ne njoftim për kontrate dhe ne dosje te tenderit.

Pra, pasi qe nuk përmbushet kriteri i kërkuar ne FDT qe thotë: Operatori Ekonomik duhet te këtë Gurëthyes te licen*cuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr, kurse* Dëshmia 6. Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje për aktivitete te veçanta, valide dhe e vlefshme e lëshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licenca e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit.

Pretendimi ankimor ne këtë pike mendojmë se është i bazuar.

Përgjigje ne pretendimin e trete ankimor

Eksperti i OSHP-se, sqaron se AK nuk i ka kthyer përgjigje OE ankues, dhe këta dy ankuesit, kane vazhduar ankesën ne OSHP, pa pranuar përgjigjen e kërkesave për rishqyrtim.

Pra, AK e ka obligim sipas LPP-se qe për çdo kërkesë për rishqyrtim brenda 3 ditëve te kthej përgjigje qofte pozitive apo negative. Pra, AK ka bere shkeljen e nenit 108/A te LPP-se, konkretisht paragrafin 2 dhe 6 te nenit 108/A te LPP-së.

Pra, AK nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së për ta shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim, deri ne datën e dorëzimit te ankesës ne OSHP, andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

AK duhet te këtë parasysh nenin 7 te LPP-se (mos-diskriminimin) e OE-ve dhe respektimin e kritereve te kërkuara sipas nenit 59 te LPP-se, duke mos anashkaluar nenin 1 të LPP-së.

Pretendimi ankimor ne këtë pike është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura (përgjigjet e dhëna me larte), eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që te ankesat te aprovohen te bazuara dhe lënda te kthehet ne Rivlerësim dhe gjate rivlerësimit, AK ti respektoj kriteret e vet-përcaktuara si ne FDT dhe NJK, sipas nenit 59 te LPP-së dhe te respektoj nenin 61 dhe 72 te LPP-së.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 17.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se.

Me kete e-mail konfirmojm pranimn e mendimit të ekspertit nr, 872 879/20 , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra LOT 1 dhe Lot 2 " me nr. Prokurimi: VU644-20-4423-5-1-1 dhe VU 644-20-050-5-1-1 i iniciuar nga AK – Komuna e Vushtrrisë.

Lidhur me lëndën e cekuar me lart ju njoftojmë se ne si AK gjate vlerësimit kemi shqyrtuar te gjitha ofertat dhe kemi ardhur deri te vendimi i tille, por qe pas paraqitjes se ankesave ne OSHP, ne tani më jemi ne pritje të një vendimi meritor nga OSHP dhe çdo vendim qe do të merr OSHP si organ kompetent ne do të pranojmë dhe do të zbatojmë përkitazi me legjislacionin përkatës ne fuqi.

Kërkojmë mirëkuptim e juaj dhe besojmë se do ta kemi një vendim në afatin me të shpejt kohor të mundshme në mënyrë që të na u mundësohet realizimi i projektit sepse tani më jeni në fundin e vitit 2020.

Ne po ashtu e kuptojmë situatën e pa zakontë në të cilën gjendemi për shkak të pandemisë por besojmë në angazhimin dhe profesionalizimin e juaj.

Ndërsa me 23.11.2020 ka njoftuar OSHP-ne se:

Të nderuar,
Me ketë e-mail edhe një here konfirmojm pranimn e mendimit të ekspertit nr, 872 879/20 , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra LOT 1 dhe Lot 2 " me nr. Prokurimi: VU644-20-4423-5-1-1 dhe VU 644-20-050-5-1-1** i iniciuar nga AK – Komuna e Vushtrrisë.
Lidhur me lëndën e cekuar me lart ju njoftojmë se ne si A.K pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues të OSHP-së, por kërkojmë me mirëkuptim që kjo lëndë të trajtohet në afatin me të shpejt kohor të mundshme dhe të kemi një vendim meritor.
Ne po ashtu e kuptojmë situatën e pa zakontë në të cilën gjendemi për shkak të pandemisë por besojmë në angazhimin dhe profesionalizimin e juaj.
Ju falënderojmë për bashkëpunimin e juaj!
Me respekt!
DPP – Vushtrri.

Ndërsa me datën 07.12.2020 ka njoftuar OSHP-ne si me poshtë:

From: Prokurimi Vushtrri
Sent: Monday, December 7, 2020 11:59 AM
To: OSHP; fehmi krasniqi; haxhakom@hotmail.com
Cc: Ardian Behra; Blerim Dina; Nuhi Paqarizi; Goran Milenkovic; Xhevdet Bushi
Subject: RE: 872 879/20 eksp
Të nderuar,
Ju shkruajm përseri, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Asfaltimi i rrugëve lokale neper fshatra LOT 1 dhe Lot 2 " me nr. Prokurimi: VU644-20-4423-5-1-1 dhe VU 644-20-050-5-1-1** i iniciuar nga AK – Komuna e Vushtrrisë, ku pasi qe kemi analizuar edhe një here lenden ne tersi kemi vrenjtur se neve si A.K na u është përvjedhur një gabim lidhur me vlerësimin e ekspertizës se ekspertit shqyrtues, ku kemi konstatuar se të gjeturat ne ekspertizë janë jo të argumentuara, andaj vlerësimi ynë përfundimtar është se ne nuk pajtohemi me të gjeturat e ekspertit në ekspertizën e dhënë dhe kërkojmë nga paneli shqyrtues i OSHP-së që sa ma pare të shqyrtoj dhe vendos lidhur me lenden në fjale vendimin e te cilit ne si A.K do ta zbatojmë në tersi.

Duke mbetur me shprese se lënda do të trajtohet sa me pare nga ana e juaj (panelit shqyrtues te OSHP-së) ne presim një përgjigjeje pozitive lidhur me ketë çështje. Po ashtu na lejoni të ju informojmë se lidhur me vonesat e shkaktuara për ketë lende kane ardh si pasoj e mungesës se stafit për shkak të pandemisë **Covid-19**, shpresojmë në mirëkuptimin e juaj.
Me respekt!
DPP – VU

Operatori Ekonomik "Rahovica Comerce"– Ferizaj, me datë: 16.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Haxha-Kom" - Skenderaj, me datë: 17.11.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se PAJTOHET me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Rahovica Comerce"– Ferizaj që ka të bëjë me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK nuk i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues sipas nenit 108/A te LPP-së. Pas çdo kërkesë për rishqyrtim, AK duhet të pezulloj aktivitetin e prokurimit dhe duhet të kthej përgjigjen brenda afatit kohor. Paragrafi 2 i nenit 108/A të LPP-së thotë: "Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar".
Pas pezullimit AK duhet të kthej përgjigjen sipas afatit kohor të paraparë me paragrafin 6 të nenit 108A te LPP-së. Paragrafit 6 të këtij neni që thotë: "Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë".
Pra, AK nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së për ta shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim, deri ne datën e dorëzimit të ankesës në OSHP. Andaj, pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Rahovica Comerce"– Ferizaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në dosjen e OE ankues gjendet një marrëveshje-para kontratë e nënshkruar në mes të OE "Rahovica Comerce" dhe z. Gazmend Himaj (menaxher i projektit) inxhinieri i dipl. ndërtimtarisë. Kontrata është e nënshkruar me dt.17.09.2020 deri në përfundim të projektit "Asfaltimi i rrugëve në lokale në fshatra LOT 1 dhe LOT 2" me nr.prok.VU-644-20-4423-5-1-1. Sipas dëshmive të bashkangjitura në dosjen e OE ankues, kriteri i kërkuar në FDT dhe njoftimin për kontratë plotësohet nga OE "Rahovica"-Ferizaj.

Kriteri i kërkuar i AK-së te Kërkesa 2 është:

Një (1) inxhinier i dipolumar i Ndërtimtarisë apo master, 3 vite përvojë pune pas diplomimit (drejtimi Konstruktiv), në detyrë të menaxherit të projektit, i emëruar me vendim përgjegjës i drejtpërdrejt për ekzekutimin e projektit. Të ketë menaxhuar së paku një (1) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).

Dëshmia 2. dëshmitë e kërkuara si vijon Për pikat a dhe b Diploma kopje, CV-a kopje e nënshkruar, referenca e lëshuar nga punëdhënësi për projektin e realizuar e nënshkruar dhe e vulosur, Kontrata e punës apo Parakontrata e punës e nënshkruar nga Punëmarrësi dhe Punëdhënësi si dhe e vulosur nga Punëdhënësi, të dorëzohet në kopje. Vendimi mbi caktimin e menaxherit projektit dhe udhëheqësit të punishtes të projektit i nënshkruar dhe i vulosur.

Lidhur me inxhinierin në fjalë, në dosjen e OE ankues gjendet para-kontrata, CV, Diploma, referencat e kryerjes se punimeve, gjë qe nënkuptohet se OE ankues e plotëson kriterin e kërkuar të AK-së si në FDT dhe Njoftimin për Kontratë.

Lidhur me sqarimin e AK-së që i ka kërkuar Inxhinierit të ndërtimtarisë - Gazmend Himaj, sqarojmë se AK ka qene dashtë ti kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së nga OE ankues (OE Rahovica), pasi qe inxhinieri në fjale është punëtor i kompanisë "Rahovica Comerce", pasi që ofertues është operatori ekonomik e jo individi (inxhinieri). Për të gjitha sqarimet, AK është dashur të kërkoj sqarime shtesë nga OE, si në rastin konkret nga OE "Rahovica Comerce", këtë e përcakton edhe paragrafi 1 i Nenit 72 i LPP-së që thotë se:

"Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës".

Pra, AK është dashur ta sqaroj sipas nenit 72 te LPP-se, për inxhinierin ne fjale, por ne rastin ne fjale AK i ka kërkuar sqarime direkt inxhinierit, gjë qe AK nuk e ka respektuar si duhet nenin 72 të LPP-së, sepse ofertimi është si kompani e jo si individ. Po ashtu, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave AK-Komuna

Vushtrri i ka kërkuar sqarime inxhinierit të ndërtimtarisë Gazmend Himaj, ku i njëjti thotë se nuk jam inxhinier i kompanisë dhe se punoj në një kompani tjetër. Sipas sqarimit që ka kërkuar AK- Komuna e Vushtrrisë nga inxhinieri i ndërtimtarisë, Gazmend Himaj, thotë (citim): "Une nuk kam nënshkruar asnjë dokument lidhur me projektin ne fjale, si marrëveshje bashkëpunimi apo parakontrate. Ju njoftoj personalisht se përgjegjësitë qe rrjedhin nga ajo parakontrate pasi qe unë personalisht nuk e kam nënshkruar atë kontrate. Ne fund edhe një here deklarohem se diploma, CV janë keqpërdorur pa dijeninë time dhe unë aktualisht jam i punësuar ne kompaninë DT Mining Sh.p.k dhe VB Invest Sh.p.k, dhe aty jam punëtor i rregullte.

Ne dosjen e OE ankues "Rahovica Comerce" gjendet një Vërtetim i diplomës me noter i cili vërtetim është bere nga vet z. Gazmend Himaj. Dokumenti noterial ka këtë numër: LRP, Nr. rendor 15039/2019, e datës 20.12.2019. Si është e mundur të paguhen kontributet për një person nga OE me të cilin ka para/kontratë pune, e ka CV-në në dosje, diplomën e noterizuar nga vet inxhinieri (Himaj), është i deklaruar në listën e ATK-së për muajin 09/2020 që i ka paguar kontributet pensionale, kurse i njëjti thotë se nuk jam punëtor i kompanisë dhe nuk kam nënshkruar asnjë dokument. Po ashtu, në dosjen e OE ankues gjendet një mesazh i cili është i printuar nga OE ankues, ku i njëjti mesazh është dërguar përmes telefonit-viberit nga inxhinieri i ndërtimtarisë z. Gazmend Himaj, ku thotë (citim): Fehmi dhe Endrit ju kërkoj falje për këtë qe ka ndodh nuk ju kam bo unë me beso, dikush ka shpiunu ne firmën time dhe i ka tregu qe i kam letrat te ju. Dhe me beso nuk kam dashtë me ta bë ketë sikurse nuk ta kam ba edhe ne tenderat e tjerë por nuk e kam ba me deshire me beso. Nuk pata qa bojë se nuk munda me humb punën se mu rreziku edhe vendi i punës dhe spata zgjidhje tjetër se edhe unë kam familje. Jam tmerrësisht keq për këtë qe na ndodhi. Ju kërkoj falje shume shume ishalla ma bani hallall.

Mesazhi kthyes i përfaqësuesit të OE ankues "Rahovica Comerce" qe i është drejtuar inxhinierit Himaj është: Pershndetje Gaz, ti ki marrëveshje me mu dhe ke me tregu para Policisë sa pare ke marr sepse kam dëshmi qe rroge ke marr prej kompanisë time, për këto lojna ke gabu ti me gjithë qata qe te kane shti ne ketë loje, se mendoj se ka ligj ne këtë vend. Pra, përmes mesazhit inxhinieri nuk e mohon se nuk është punëtor i kompanisë. Po ashtu në dosjen e OE ankues gjinden edhe disa mesazhe tjera qe është paguar si punëtor i kompanisë, gjinden foto te inxhinierit me përfaqësuesit e kompanisë për nënshkrim te kontratës etj, ashtu siç e pohon OE ankues ne ankesën e tij.

Kurse sa i përket sqarimit te kërkuar nga AK për inxhinierin ne fjale, ne dosjen e ankesës gjinden disa dëshmi se OE ankues e ka te punësuar inxhinierin ne fjalë, ku është i deklaruar ne listën e pagave te periudhës 09/2020 te dorëzuar ne ATK i cili ka page 250.00 €.

Pra, këtë liste te pagave te ATK-së, OE ankues e ka dërguar ne kërkesën për rishqyrtim ne Autoritetin Kontraktues Komuna Vushtrri.

Lidhur me këtë pretendim, pasi qe ne dosjen e tenderit gjinden para kontrata, diploma, CV-ja, mesazhet kërkim falëse te inxhinierit zt.Gazmend HIMAJ, noterizimi i diplomës, dëshmitë e pagesave etj. Bazuar ne dëshmitë qe gjinden ne dosjen e OE ankues, ne momentin e dorëzimit OE i ka përmbush kriteret e FDT-së, njoftimit për kontratë, se inxhinieri në fjale ka para kontratë, ka diplomën e noterizuar, lista e punëtorëve deklaruar ne ATK për muajin 09/2020, ku inxhinieri Gazmend Himaj është edhe si i punësuar. Duke pasur parasysh këto komunikime dhe kërkesën e AK-së për sqarime shtesë nga inxhinieri në kundërshtim me nenin 72, Paneli Shqyrtues sqaron se përderisa ekziston një kontratë e noterizuar nga vet inxhinieri, atëherë kjo kontratë është e vlefshme, kontratat e noterizuara nuk prishen me deklarimeve verbale të njëanshme apo në formë të shkruar përmes e-mailit. Andaj, ky pretendim ankimor i OE ankues ne këtë pike është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues që ka të bëjë me arsyetimin e AK-së se ne si OE nuk i kemi referencat për plotësimin e kriterit te kërkuar: Kërkesa 1. Projekte të përfunduara të punëve të ngjashme (ndërtim, rehabilitim, rikonstruimit të rrugëve) në tre vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, jo më pak se për LOT-1 1,299,064.91€, dhe për LOT-2 1,820,261.43€ Në rast Grupit të Op.Ek. lideri i grupit duhet të ketë kontrata të punës të realizuara gjatë tre viteve të fundit deri më datën e publikimit të Njoftimit për Kontratë jo më pak se 60% të vlerës së saktësuar si më lartë.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE ankues në listën e projekteve ka projekte me vlerë 3,224,674.00 €, ku nga ato projekte AK duhet të kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ku duke u bazuar në nenin 1 dhe 6 të LPP-së, qëllimi i ligjit është shfrytëzimi sa me ekonomik i buxhetit dhe AK ti kërkoj sqarime shtese në fazën e rivlerësimit që në rast se arrihet kriteri i kërkuar nga OE ankues, AK te shpërblen me kontratë OE ankues. Në rast se nuk arrihet kriteri i kërkuar, AK të vazhdoj me OE tjerë. Pra, qëllimi i LPP-së konkretisht nenit 59.2, nenit 72 të LPP-së dhe nenit 39.8 të RrUOPP-së është ti kërkohen sqarime shtese. Pra, AK duke u bazuar ne nenin 1 dhe 6 të LPP-së që interesi i AK është të kursej buxhetin, AK duhet të ketë parasysh këto gjera dhe ka qenë dashtë të kërkoj sqarime sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, lidhur me listën e projekteve, konkretisht referencat. Pretendimi ankimor i OE ankues është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues për çmime jo normalisht te ulëta, sipas pozicioneve te përshkruara si me poshtë: Ne pozicionin nr.7 Furnizimi dhe punimi i pusetave te reja duke përfshirë furnizimin dhe montimin e gypave te pesetës Ø 1000 se bashku me konus Ø 1000/600 si kapaku prej kompoziti me peshe 40 T.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar "Bageri", ka ofertuar me çmim 1.00 €, kurse OE ankues ka marr oferta nga prodhues ku çmimi është 100.00 €, pasi që OE ankues thotë: "ne jemi importues të kapakëve kompozitë, kurse ne kemi ofertuar me çmim 120.00 €". Si është e mundur

ne si importues e kemi çmimin 120.00 €, kurse OE i rekomanduar e ka çmimin 1.00 €. Po ashtu edhe në pozicionin nr.9 Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe sekondar ne kat.III-IV të dheut me makinë në gjerësi B=60 cm, ku OE i rekomanduar ka çmim 0.10 €, kurse çmimi real për punë të tilla është min.1.00 € (m3). Në pozicionin nr. 19 Furnizimi dhe betonimi i elementeve konstruktive me beton te armuar C25-30 Mpa, sipas projektit, ku OE i rekomanduar ka çmim 1.00 €, kurse siç pretendon OE ankues se çmimi i tregut është 40-45 € = 1 m3. Pra, si është e munduar me 1.00 € të vendoset çmimi për 1 m3 beton C25-30. Në pozicionin nr.10 Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave te brinjëzuar PE SN 8 për kolektorët e kanalizimit fekal PESN8 Ø 315 mm, ku OE i rekomanduar ka vendosur çmim 0.20 € për 1 metër gjatësi, kurse siç pretendon OE ankues se çmimi i tregut është çmimi nga 6.00 – 6.50 €, ku ne (OE ankues) kemi ofertuar me çmim 7.00 €. Në pozicionin nr. 20 Blerja, transporti, prerja dhe vendosja e armaturës ÇBR-400/500 Mpa në tërësi në të gjitha pozicionet sipas llogarisë statike, ku OE i rekomanduar ka ofertuar 0.01 €/kg, ku vetëm blerja kushton 1 kg = 0.40 €, siç pretendon OE ankues. Pra, si është e mundur OE "Bageri" të oferton me 0.01 €, ku as në prodhim nuk është më lirë se 0.33 €/kg. Këtu shihet haptas se ka çmime jo-normalisht të ulëta, dhe AK nuk ka vepruar fare sipas nenit 61 te LPP-se për ti vërtetuar këto çmime!

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se të gjitha çmimet që i ka potencuar OE ankues në ankesën e tij, shihet se janë çmime të cilat janë të lira dhe obligim dhe përgjegjësi e AK-së është të kërkoj sqarime sipas paragrafit 2 të nenit 61 të LPP-se dhe Neni 4 (procedura e shqyrtimit) i Rregullores për çmime jo-normalisht te ulëta Neni 4 -Procedura e shqyrtimit (inter partes). Paragrafi 2 i nenit 61 te LPP-së thotë (citim): Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

1. ekonominë e procesit të prodhimtarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;
2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur
3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve,
4. ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose
5. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Pretendimi i ankimor i OE ankues në këtë pikë është i bazuar sepse AK është dashur ti kërkoj sqarime shtesë OE ankues për çmime jo normalisht te ulëta.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, ku kërkesa e kërkuar nga AK ka qenë në FDT dhe NJK:

Kërkesa 6. Operatori Ekonomik duhet te këtë Gurëthyes te licencuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr.

Dëshmia 6. Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje për aktivitete te veçanta , valide dhe e vlefshme e lëshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licenca e OE. Marrëveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar nuk e ka te noterizuar marrëveshjen për Furnizim me zhavorr ne emër te qiramarrësit dhe qiradhënësit, kurse OE i rekomanduar nuk e plotëson këtë kriter. Pra, nuk është marrëveshja e noterizuar sipas kërkesës së AK-së, por ka vetëm vërtetim nënshkrimi i dt.11.03.2020, ku thotë se Noteri në kuptim të nenit 46 vërteton dokumentin kopje nga origjinali, gjë që e vërteton se nuk është marrëveshja e noterizuar për projektin, por është vetëm vërtetim nënshkrimi i kopjes së marrëveshjes. Lidhur me këtë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues vlerëson se nuk e përmbush plotësisht kriterin e kërkuar të AK-së i cili është kërkuar në FDT dhe njoftimin për kontratë. Pra, AK ka shkelur nenin 59 te LPP-se, konkretisht paragrafi 4 i këtij neni qe thotë:

> "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Ashtu siç pretendon OE ankues se OE i rekomanduar nuk e ka marrëveshjen e noterizuar në mes të qiradhënësit dhe qiramarrësit, pos që e ka noterizimin e bërë nga pronari për LOT 2 – Bujar Shabani. Pra, duke u bazuar në kërkesën e AK-së dhe dëshmitë që OE i rekomanduar i ka futur në dosje, nuk e plotëson kriterin e kërkuar OE i rekomanduar. AK duhet te këtë parasysh nenin 7 të LPP-së (mos-diskriminimin) e OE-ve dhe respektimin e kritereve te kërkuara sipas nenit 59 të LPP-se, duke mos anashkaluar nenin 1 të LPP-së, nenin 6, nenin 61 dhe 72 të LPP-së. Pra, pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Haxha-Kom" – Skenderaj, se AK ka shkel nenin 61 të LPP-së. Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK nuk e ka respektuar nenin 61 të LPP-së në lidhje me tenderin jo-normalisht të ulët, ku ceket qartë se: Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2. të këtij neni.

Pra, AK-ja nuk i ka respektuar dispozitat e lartcekura te nenit 61 te LPP-së pasi qe nuk i ka kërkuar fare sqarime shtesë ne lidhje me çmimin e OE se rekomanduar për kontratë dhe duke na diskriminuar neve si OE i përgjegjshëm ne këtë aktivitet te prokurimit.

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues "Haxha-Kom" – Skenderaj, Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se pretendimi i njëjtë është shqyrtuar edhe në ankesën nr.872/20. Andaj, duke u bazuar ne faktet e lartcekura shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kriterin e kërkuar si në FDT sepse marrëveshja nuk është e noterizuar në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit, por marrëveshja është noterizuar nga Bujar Shabani LOT 2, dhe Valdrin Shabani LOT 1, por nuk është e noterizuar në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit, ashtu siç është përcaktuar në njoftim për kontratë dhe në dosje të tenderit. Pra, pasi që nuk përmbushet kriteri i kërkuar në FDT që thotë: Operatori Ekonomik duhet te këtë Gurëthyes te licen*cuar ne pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr, kurse* Dëshmia 6. Duhet të dëshmohet kopja e Licencës leje për aktivitete te veçanta, valide dhe e vlefshme e lëshuar nga Agjencia për Miniera dhe Minerale. Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon licencën, duhet ofruar Marrëveshjen për furnizim me OE te licencuar. Bashkangjitur duhet te jete Licenca e OE. Marreveshja duhet te jete e noterizuar ne mes te qiramarrësit dhe qiradhënësit. Pretendimi ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Haxha-Kom" – Skenderaj, se AK nuk i ka kthyer përgjigje dhe këta dy ankuesit, kane vazhduar ankesën ne OSHP, pa pranuar përgjigjen e kërkesave për rishqyrtim.
Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK e ka obligim sipas LPP-së që për çdo kërkesë për rishqyrtim brenda 3 ditëve të kthej përgjigje çoftë pozitive apo negative. Pra, AK ka bërë shkeljen e nenit 108/A të LPP-se, konkretisht paragrafin 2 dhe 6 te nenit 108/A te LPP-së. Rrjedhimisht, AK nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së për ta shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim, deri ne datën e dorëzimit te ankesës ne OSHP, andaj pretendimi ankimor i OE ankues është i bazuar.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorëve ekonomik ankues, shkresave të lëndës dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik konform nenit 7 të LPP-së, duke anashkaluar nenin 1 të LPP-së, si dhe nuk e ka bërë vlerësimin në harmoni me nenin 59 të LPP-së. Andaj, obligohet AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së duke mos diskriminuar asnjërin operator ekonomik ashtu siç është përcaktuar në nenin 7 të LPP-së, si dhe të ketë parasysh qëllimin e ligjit duke bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.
Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më

të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Komuna Vushtrri";

1x1 OE "Rahovica Comerce"– Ferizaj;

1x1 OE "Haxha-Kom" – Skenderaj;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.